

# Statistikat e transportit\*

## Nëntor 2020

**Tiranë, më 23 Dhjetor 2020:** Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Nëntor 2020 është 426 mijë ton, duke u rritur 32,0 % krahasuar me Nëntor 2019.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 3.919 mijë ton, duke u ulur me 4,4 %, krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019.

Në muajin Nëntor 2020, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 2.339 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 42,8 %, krahasuar me Nëntor 2019.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 23.279 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 42,0 %, krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019.

**Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër, Nëntor 2020**

Periudha	Me det/ton	Hekurudhë 000/ton.km	Ajër/ton*
Nëntor 2019	322.313	4.089	202.8
Nëntor 2020	425.571	2.339	159.4
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>32,0</b>	<b>-42,8</b>	<b>-21,4</b>
Janar-Nëntor 2019	4.100.646	40.112	2.124,7
Janar-Nëntor 2020	3.919.040	23.279	1.616,7
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-4,4</b>	<b>-42,0</b>	<b>-23,9</b>

\* Përfshin mallrat dhe postën

**Burimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në muajin Nëntor 2020, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 159,4 ton, duke u ulur me 21,4 %, në krahasim me Nëntor 2019.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 1.616,7 ton duke u ulur me 23,9 %, krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019.

Në Nëntor 2020, numri i fluturimeve të kryera është 1.246 duke shënuar një rënie me 41,4 %, në krahasim me Nëntor 2019.

**Për publikim 23/12/2020**

Vijon

**Tab. 2 Treguesit specifike të transportit ajror, Nëntor 2020**

Periudha	Numri i shoqërive ajrore*	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Nëntor 2019	17	2.126	9.974
Nëntor 2020	14	1.246	4.237
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-17,6</b>	<b>-41,4</b>	<b>-57,5</b>
Janar- Nëntor 2019	17	26.365	177.757
Janar- Nëntor 2020	14	14.226	82.414
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-17,6</b>	<b>-46,0</b>	<b>-53,6</b>

\*Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat janë licensuar të kryejnë fluturime në fillim të vitit

**Burimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Në Nëntor 2020, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 21.013 pasagjerë. Krahasuar me Nëntor 2019, ky tregues është ulur 63,4 %. Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020, kanë udhëtuar me linjë detare 344.660 pasagjerë, duke u ulur me 77,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në muajin Nëntor 2020, transporti ajror i pasagjerëve zë 77,2 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020 është 1.224.874 pasagjerë duke u ulur me 60,1 %, krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e 2019.

**Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit, Nëntor 2020**

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Nëntor 2019	136	57.335	232.588
Nëntor 2020	562	21.013	73.065
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>313,2</b>	<b>-63,4</b>	<b>-68,6</b>
Janar- Nëntor 2019	59.530	1.495.495	3.066.488
Janar- Nëntor 2020	17.523	344.660	1.224.874
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-70,6</b>	<b>-77,0</b>	<b>-60,1</b>

**Burimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

### **Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit**

Në Nëntor 2020, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 83,0 mld lekë dhe 49,3 % e tyre u transportua me det.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 792,6 mld lekë dhe 49,5 % e tyre u transportua me det.

**Eksportet e mallrave**

Në Nëntor 2020, mallrat e eksportuara me det zënë 55,8 %, me rrugë 41,6 % dhe me ajër 0,3 %. Mallrat e eksportuara me rrugë në Nëntor 2020 janë rritur me 13,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.


**Tab.4 Eksporti i mallrave sipas mënyrave të transportit, Nëntor 2020**

Periudha	Eksport (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudhë	Me rrugë	Me ajër	Të tjera
Nëntor 2019	14.565	-	10.023	75	80
Nëntor 2020	15.242	-	11.374	87	637
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>4,6</b>	<b>-</b>	<b>13,5</b>	<b>15,0</b>	<b>693,2</b>
Janar-Nëntor 2019	163.688	4	108.497	1.297	3.403
Janar-Nëntor 2020	138.244	5	105.787	1.143	3.662
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-15,5</b>	<b>14,7</b>	<b>-2,5</b>	<b>-11,9</b>	<b>7,6</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020, mallrat e eksportuara me det zënë 55,6 %, me rrugë 42,5 % dhe me ajër 0,5. Mallrat e eksportuara me rrugë janë ulur 2,5 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

**Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Nëntor 2020**



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

**Importet e mallrave**

Në Nëntor 2020, mallrat e importuara me det zënë 46,1 %, me rrugë 47,8 % dhe me ajër 3,0 %. Mallrat e importuara me rrugë në Nëntor 2020 janë rritur me 10,2 % krahasuar me Nëntor 2019.


**Tab.5 Importi i mallrave sipas mënyrave të transportit**

Periudha	Import (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudh	Me rrugë	Me ajër	Të tjera
Nëntor 2019	24.409	222	24.129	2.040	2.177
Nëntor 2020	25.634	233	26.600	1.690	1.476
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>5,0</b>	<b>4,9</b>	<b>10,2</b>	<b>-17,1</b>	<b>-32,2</b>
Janar-Nëntor 2019	288.618	4.021	257.895	18.674	24.385
Janar-Nëntor 2020	254.227	2.703	256.836	15.674	14.327
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-11,9</b>	<b>-32,8</b>	<b>-0,4</b>	<b>-16,1</b>	<b>-41,2</b>

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT*

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020, mallrat e importuara me det zënë 46,8 %, me rrugë 47,2 % dhe me ajër 2,9 %. Mallrat e importuara me rrugë janë ulur me 0,4 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

**Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Nëntor 2020**



*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritjet të INSTAT*

# Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve, sipas llojeve, si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit, në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Përkufizime

**Transport:** Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

**Transporti hekurudhor:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

**Transport detar:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

**Transport ajror:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

**Eksportet** janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

**Vlera F.O.B:** Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

**Importet** janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

**Vlera C.I.F:** Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

**Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007)** është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

*Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).*

## Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash